



MUAJI SHKURT

- 1. E hënë.** *Parakremtja e Paraqitjes së Zotit tonë Jisu Krisht në Tempull.* Dëshmor Trifoni. Dëshmore Perpetua, Felicitia etj. Oshënare Brixhida në Irlandë.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i shenjtit (Rom. 8:28-39).

UNGJILLI i shenjtit (kërkoje të hënë e javës së 15-të të Mattheut - Mk. 5:24-34).

- 2. † E MARTË. PARAQITJA E ZOTIT, PERËNDISË DHE SHPËTIMTARIT TONË JISU KRISHT NË TEMPULL (IPAPANDIA).**

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 3 Vargëzimet e përshembullta të së kremtes, të cilat bëhen 6 (thuhet të tria nga 2 herë). “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, Paravargu i ditës dhe leximet biblike (**Leximi I:** Eks. 12:51-13:3, 10:12, 14-16; 22:28; Lev. 12:2-4, 6, 8; Num. 8:16-17; **Leximi II:** Isa. 6:1-12; **Leximi III:** Isa. 19:1-5, 12, 16, 19-21).

PASVARGJET e së kremtes. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

PËRLËSHORJA e së kremtes: “Gëzohu, o Hirplote...” (3 herë).

PËRLËSHIMI: “Ai që pranoi të mbahet në duart e Simeonit të drejtë për shpëtimin tonë, Krishti, Perëndia ynë...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e së kremtes: “Gëzohu, o Hirplote...” (3 herë).

NDENJËSORET e së kremtes. SHKALLESAT: “Që prej rinisë sime...” dhe PARAVARGU i së kremtes.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor i së kremtes (Llk. 2:25-32).

Pas Ungjillit lexohet PSALMI 50. Dhe më pas thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, tropari i vetëmelodishëm i së kremtes. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e së kremtes. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET e Kryqit: “Fundin edhe burimin...”.

MADHËSHTIMET: Pas Këngës VIII thuhet thirrja: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...” dhe, në vend të: “Më të nderuarën...”, psalen Madhështimet e së kremtes: “Kurrë nuk merret vesh...” dhe Zbritësorja IX: “O Hyjlindëse Mari... Në Ligjin dhe Shkrimet...”.

DËRGIMSORJA e së kremtes (3 herë).

LAVDËRIMET: psalen 3 Vargëzimet e përshembullta të së kremtes, të cilat bëhen 4 (e para thuhet 2 herë). “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

DHOKSOLOGJIA e Madhe, Përlëshorja e së kremtes (1 herë).

Në Liturgji:

ANDIFONET e së kremtes. Refreni i Andifonit II: “Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, që të mbajti Simeoni në krahë, ne që të psalim: Aliluia”.

HYRTORJA: “Zoti bëri të njohur shpëtimin... Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, që të mbajti Simeoni në krahë, ne që të psalim: Aliluia”.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja dhe Shkurtorja e së kremtes.

APOSTULLI i së kremtes (Heb. 7:7-17).

UNGJILLI i së kremtes (Llk. 2: 22-40).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet Zbritësorja IX: “O Hyjlindëse Mari... Në Ligjin dhe Shkrimet...”.

KUNGATORJA e së kremtes: “Kupë shpëtimi...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

Shënim: Nga nesër dhe deri në mbylljen e së kremtes, në Liturgjinë Hyjnore psalen Andifonet e së kremtes, por thuhet Hyrtojra e zakonshme: “Ejani t’i falemi... Shpëtona... që të mbajti Simeoni në krahë, ne që...”.

3. † E mërkurë. Simeon Hyjpritësi. Profetesha Ana. Nikolla i Japonisë. Dëshmor Vlashi.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i ditës (kërkoje të dielën e javës së 18-të të Letrave - 2 Kor. 9:6-11).

UNGJILLI i shenjtorëve (Llk. 2:25-38).

4. E enjte. Oshënar Isidor Pilusioti. Dëshmor Theoktisti. Oshënar Jasim mrekullibërësi. Oshënar Joani. Nikolla Omologjeti (Pohuesi).

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i ditës (kërkoje të dielën e javës së 14-të të Letrave - 2 Kor 1:21-2:4).

UNGJILLI i ditës (kërkoje të dielën e javës së 14-të të Mattheut - Mtth. 22:2-14).

5. E premte. Dëshmore Agathia. Poliefkti i Konstandinopojës. Oshënar Sava i Ri, në Sicili.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i ditës (kërkoje të premten e javës së 15-të të Letrave - Gal. 4:8-21).

UNGJILLI i ditës (kërkoje të dielën e 15-të të Mattheut - Mtth. 22:35-46).

6. † E shtunë. Oshënar Bukoli i Smirnës. Foti i Madh, patriark i Konstandinopojës. Oshënari i madh Varsanufi. Dëshmore Fausta.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i ditës (kërkoje të shtunën e javës së 15-të të Letrave - 1 Kor. 4:17-5:5).

UNGJILLI i ditës (kërkoje të shtunën e javës së 15-të të Mattheut - Mtth. 24:1-13).

7. † E DIEL. XVI MATTHEUT. (Shëmbëlltyra e talantave). Partheni i Lampsakës. Oshënar Llukai në Stiri.
Tingulli II. Ungjilli mëngjesor ngjallësor II.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 6 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e së kremtes, të cilat bëhen 4. “Lavdi...”, e së kremtes. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. II: “Shkoi hija e ligjit...”.

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe Paravargu i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Kur zbritë te vdekja...”. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes: “Gëzohu, o Hirplote...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja ngjallësore: “Kur zbritë te vdekja...”. “Lavdi...”, po ajo: “Kur zbritë te vdekja...”. “Tani...”, e së kremtes: “Gëzohu, o Hirplote...”.

NDENJËSORET ngjallësore, por në vend të Hyjlindësoreve të çdo stikologjie (grupi), psalen Ndenjësoret e së kremtes.

BEKIMTORET ngjallësore. DËGJIMI, SHKALLESAT dhe PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA ngjallësore. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET: “Fundin edhe burimin...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor II.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Kur u ngrit Jisui...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe Zbritësorja IX: “O Hyjlindëse Mari... Ligjin dhe Shkrimet...”.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore II dhe e së kremtes.

LAVDËRIMET: psalen 4 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e së kremtes, të cilat bëhen 4. “Lavdi...”, lavdia mëngjesore ngjallësore II. “Tani...”, “E përmbibekuar je...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e së kremtes. Te refreni i dytë thuhet: “Shpëtona... që u mbajte në krahë nga Simeoni, ne që...”.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, që u ngjalle së vdekurish, ne që të psalim: Alilua”.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja ngjallësore: “Kur zbritte te vdekja...”, e së kremtes: “Gëzohu, o Hirplote...” dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja e së kremtes: “O Zot, që e shenjtërove Marinë...”.

APOSTULLI i së dielës së javës së 16 -të të Letrave (2 Kor. 6:1-10)

UNGJILLI i së dielës së 16-të të Mattheut (Mtth. 25:14-30).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet “Të meriton...”.

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdëroni Zotin...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

8. E hënë. Profeti Zaharia. Dëshmorë i Madh Theodor Stratilati. Dëshmorët Likarioni, Marta etj.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i ditës (kërkoje të dielën e javës së 19-të të Letrave - 2 Kor. 11:31-12:9).

UNGJILLI i ditës (kërkoje të dielën e javës së 3-të të Llukait - Llk. 7:11-16).

9. E martë. *Mbyllja e së kremtes së Paraqitjes së Zotit tonë Jisu Krisht në Tempull (Ipapandisë).* Dëshmor Niqifori. Hierodëshmor Markeli i Sicilisë.

Shërbesa e Mbylljes (Përlëshimit) së Paraqitjes së Zotit Krisht në Tempull, kryhet njëllëj si ditën kryesore të festës (2 shkurt), por:

Në **Mbrëmësore**, gjatë kohës që psalet Lavdia e vargëzimeve të thirroreve, bëhet Hyrja, thuhet: “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe paravargu i ditës. Leximet biblike të festës nuk thuhën. Përlëshorja e së kremtes, 3 herë. Dhe Përlëshimi si ditën e së kremtes.

Në **Mëngjesore**, nuk psalen Ndenjësoret e stikologjisë (grupit) së tretë, por vetëm dy grupet e para. Nuk thuhet Ungjilli mëngjesor i së kremtes. Pra, pas dy stikologjive (grupeve) të para të Ndenjësoreve, lexohet Psalmi 50 dhe menjëherë pas tij thuhet Shkurtorja dhe Shtëpia e së kremtes, si dhe Sinaksari i datës 9 shkurt. Pas Këngës VIII, psalen Madhështimet e së kremtes, njëlloj si në datën 2 shkurt.

Nëse do të kryhet Liturgji, thuhen Andifonet, Hyrtoja, Përlëshorja dhe Shkurtorja e së kremtes.

APOSTULLI i ditës (kërkoje të dielën e javës së 30-të të Letrave - Kol. 3:12-16).

UNGJILLI i ditës (kërkoje të martën e javës së 16-të të Mattheut - Mk. 7:5-16).

Dhe vijon, si zakonisht, Liturgjia e Shën Joan Gojartit.

Te “**VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...**”, psalet Zbritësorja IX: “O Hyjlindëse Mari... Në Ligjin dhe Shkrimet...”.

KUNGATORJA e së kremtes.

10. † E mërkurë. Hierodëshmor Harallamb mbrekullibërësi. Dëshmorët Bato dhe Porfiri. Oshënar Zinon Postieri. Ana Suedezja.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 3 Vargëzimet e përshebullta të shenjtit, të cilat bëhen 6 (thuhen të gjitha nga 2 herë). “Lavdi...”, e shenjtit. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike në të njëjtin tingull me Lavdinë e shenjtit.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, PARAVARGU i ditës dhe LEXIMET biblike (**Leximi I:** Isa. 43:9-14; **Leximi II:** Urt. Sol. 3:1-9; **Leximi III:** Urt. Sol. 5:15-6:3).

PASVARGJET e shenjtit. “Lavdi...”, e shenjtit. “Tani...”, Hyjlindësorja në të njëjtin tingull me Lavdinë e Pasvargjeve të shenjtit.

PËRLËSHORJA e shenjtit: “Kolon’ e patundëshme...”. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja: “Misteri i fshehur...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PËRËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e shenjtit: “Kolon’ e patundëshme...”. “Lavdi...”, po ajo: “Kolon’ e patundëshme...”. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Misteri i fshehur...”.

NDENJËSORET e shenjtit.

SHKALLESAT: “Që prej rinisë sime...” dhe Paravargu i shenjtit.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor i shenjtit (kërkoje të martën e javës së 12-të të Llukait - Llk. 21:12-19).

Pas Ungjillit lexohet PSALMI 50. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Atloforit...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, tropari i shenjtorit. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e shenjtit. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET: “Ja gojën e çel...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe Zbritësorja IX: “Gjithë njerëzit...”.

DËRGIMSORET e shenjtit.

LAVDËRIMET: psalen 3 Vargëzimet e përshembullta të shenjtit, të cilat bëhen 4. “Lavdi...”, e shenjtit. “Tani...”, Hyjlindësorja në të njëjtin tingull me Lavdinë e shenjtit.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe Përlëshorja e shenjtit.

Në Liturgji:

ANDIFONET e të kremteve të dëshmorëve.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja e shenjtit: “Kolon’ e patundëshme...” dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja: “Mbrojtje e paturpëruar...”.

APOSTULLI i shenjtit (kërkoje më 26 tetor - 2 Tim. 2:1-10).

UNGJILLI i shenjtit (kërkoje të shtunën e javës së 3-të të Joanit - Jn. 15:17-16:2).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet “Të meriton...”.

KUNGATORJA: “I drejti do të kujtohet...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

- 11. † E enjte.** Hierodëshmor Vlasi dhe 7 dëshmorët që ishin bashkë me të. Mbretëresha Theodhora, e cila përkrahu Orthodhoksinë.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i ditës (kërkoje të enjten e javës së 16-të të Letrave – Efes. 1:1-9).

UNGJILLI i ditës (kërkoje të enjten e javës së 16-të të Mattheut – Mk. 7:24-30).

- 12. E premte.** Meleti i Antiokisë. Andoni i Konstandinopojës. Dëshmori i ri Kristo Kopshtari, shqiptar.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i ditës (kërkoje të premten e javës së 16-të të Letrave - Efes. 1:7-17).

UNGJILLI i ditës (kërkoje të premten e javës së 16-të të Mattheut - Mk. 8:1-10).

- 13. † E shtunë.** Apostujt Akila dhe Priskila, nga të 70-t. Oshënar Martiniani. Evlogji i Aleksandrisë.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i ditës (kërkoje të shtunën e javës së 16-të të Letrave - 1 Kor. 10:23-28).

UNGJILLI i ditës (kërkoje të shtunën e javës së 16-të të Mattheut - Mtth. 24:34-37, 42-44).

- 14. † E DIEL. XVII MATTHEUT (E gruas kananease).**

Oshënar Afksenti në Bitini. Oshënar Maroni. Hierodëshmor Valentini.

Tingulli III. Ungjilli mëngjesor ngjallësor III.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 7 Vargëzimet ngjallësore, që bëhen 8. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. III: “Si të mos admirojmë lindjen...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe PARAVARGU i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja e Pasvargjeve: “Pa farë prej Shpirtit të Shenjtë...”.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Le të dëfrejnë qielloret...”. “Lavdi...”, e oshënarit: “Qytetar i shkretëtirës...”. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Gabrieli kur të tha...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, Përlëshoret psalen si në Mbrëmësore.

NDENJËSORET ngjallësore sipas radhës, por te stikologjia (grupi) e parë psalet Hyjlindësorja e Përlëshoreve: “Ty që ndërmjetove për shpëtimin...”.

BEKIMTORET ngjallësore, SHKALLESAT, DËGJIMI DHE PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA e SHTËPIA e tingullit. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET: “Ja gojën e çel tani...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor III.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...” etj. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në fund Zbritësorja IX: “Gjithë njerëzit...”.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore III dhe Hyjlindësorja e saj.

LAVDËRIMET: psalen 8 Vargëzimet ngjallësore. “Lavdi...”, Lavdia mëngjesore ngjallësore III. “Tani...”, “E përmbibekuar je...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e së dielës.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja ngjallësore: “Le të dëfrejnë qielloret...”, e oshënarit: “Qytetar i shkretëtirës...” dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja: “Mbrotje e paturpëruar...”.

APOSTULLI i së dielës së javës së 17-të të Letrave - 2 Kor 6:16-7:1).

UNGJILLI i së dielës së javës së 17-të të Mattheut (Mtth. 15:21-28).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdëroni Zotin...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

15. E hënë. Apostull Onisimi, nga të 70-t. Oshënar Eusebi në Siri. Dëshmor Majori në Gaza.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i apostullit (kërkoje më 22 nëntor - Filim. 1-25).

UNGJILLI i ditës (kërkoje të hënën e javës së 16-të të Llukait - Mk. 12:13-17).

- 16. E martë.** Dëshmor Pamfili. Flaviani i Konstandinopojës. Episkop Maruthai në Persi.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së martës së javës së 33-të të Letrave (1 Pjet. 3:10-22).

UNGJILLI i së martës së javës së 16-të të Llukait (Mk. 12:18-27).

- 17. † E mërkurë.** Dëshmor i Madh Theodhor Tironi. Mbretërit Markiani dhe Pulkeria.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i së mërkurës së javës së 33-të të Letrave (1 Pjet. 4:1-11).

UNGJILLI i së mërkurës së javës së 16-të të Llukait (Mk. 12:28-38).

- 18. E enjte.** Leoni i Madh, Papa i Romës. Agapit Omologjeti (Pohuesi), episkop i Sinaut. Dëshmor Agripa, Dhorotheu, Viktorini etj.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së enjtes së javës së 33-të të Letrave (1 Pjet. 4:12-5:5).

UNGJILLI i së enjtes së javës së 16-të të Llukait (Mk. 12:38-44).

- 19. E premte.** Apostujt Arkipi, Filimoni dhe Apfia, nga të 70-t. Dëshmore e re Filothea në Athinë. Dëshmor i ri Nikita.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së premtes së javës së 33-të të Letrave (2 Pjet. 1:1-10).

UNGJILLI i së premtes së javës së 16-të të Llukait (Mk. 13:1-8[9]).

- 20. † E shtunë.** Leoni i Katania. Oshënar Visarioni, mrekuilibërës. Agathoni i Romës.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i së shtunës së javës së 33-të të Letrave (2 Tim. 2:11-19).

UNGJILLI i së shtunës së javës së 16-të të Llukait (Llk. 18:2-8).

- 21. † E DIEL. E DOGANIERIT DHE FARISEUT.**

Oshënar Timotheu. Efstathi i Antiokisë. Maksimiani i Ravenës.

Tingulli IV. Ungjilli mëngjesor ngjallësor IV.

Fillon Triodi

Shënim: Nga sot e në vazhdim fillojnë të psalen himnet që ndodhen në librin liturgjik të Triodit.

Në fillim të Mbrëmësore, Libri i Triodit vendoset në një ikonambajtës të lëvizshëm përpara ikonës së Krishtit, tek ikonostasi. Protopsalti zbrit nga psaltiri, shkon tek ikona e Krishtit, bën tri metani para ikonës së Krishtit, puth ikonën, merr librin e Triodit, e puth atë, bën sërish tri metani dhe, me librin e Triodit në dorë, kthehet në vendin e tij në psaltir.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...”, thuhet 7 Vargëzime ngjallësore dhe 2 vargëzimet e vetëmelodishme të Triodit, të cilat bëhen 3 (e para thuhet 2 herë). “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. IV: “Profeti David, që prej teje...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe PARAVARGU i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja e Pasvargjeve të tingullit, por sipas tingullit të Lavdisë.

PËRLËSHORET ngjallësore: “Lëçitjen gazmore...”. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja: “Misteri i fshehur...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PËRËNDI ËSHTË ZOTI...”, Përlëshorja ngjallësore: “Lëçitjen gazmore...”. “Lavdi...”, po ajo: “Lëçitjen gazmore...”. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Misteri i fshehur...”.

NDENJËSORET ngjallësore sipas radhës.

BEKIMTORET ngjallësore, DËGJIMI, SHKALLESAT dhe PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA (e tingullit dhe e Triodit), SHTËPIA (e tingullit dhe e Triodit) dhe SINAKSARI (i ditës dhe i Triodit).

ZBRITËSORET: “E kapërceu me këmbë detin...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor IV.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Hapmi dyert e pendimit...”. “Tani...”, “Drejtomë në rrugët...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Unë i mjeri, duke kujtuar...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në fund Zbritësorja IX: “Asnjë njeri Perëndinë...”.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore IV dhe e Triodit.

LAVDËRIMET: 4 Vargëzime ngjallësore dhe 4 Vargëzimet e Triodit (thuhen dy Vargëzimet e Thirrtoreve dhe dy të Lavdërimeve). “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, “E përmbibekuar je, o Hyjlindëse...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e të dielave.

Pas HYRJES, Përlëshorja ngjallësore dhe e shenjtiti të kishës.

SHKURTORJA e Triodit.

Paravargu dhe Aliluari i së dielës.

APOSTULLI i së dielës së javës së 33-të të Letrave
(2 Tim. 3:10-15).

UNGJILLI i së dielës së 17-të të Llukait
(Llk. 18:10-14).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdëroni Zotin...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

22. E hënë. Gjetja e lipsaneve të dëshmorëve të shenjtë
në Evgjëni. Oshënarët Thalasi, Limneu.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së hënës së javës së 34-t të Letrave
(2 Pjet. 1:20-2:9).

UNGJILLI i së hënës së javës së 17-të të Llukait
(Mk. 13:9-13).

23. E martë. Hierodëshmor Polikarpi i Smirnës.
Dëshmore Gorgonia. Dëshmor Sereni.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së martës së javës së 34-t të Letrave
(2 Pjet. 2:9-22).

UNGJILLI i së martës së javës së 17-të të Llukait
(Mk. 13:14-23).

24. † E mërkurë. Gjetja e parë dhe e dytë e kokës së
Joan Pagëzorit. Mbreti Etelbert në Kent.

Hahen të gjitha.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i Pararendësit (2 Kor. 4:6-15).

UNGJILLI i Pararendësit (Mtth. 11:2-15).

25. E enjte. Tarasi i Konstandinopojës. Hierodëshmor Regjini dhe 40 dëshmorët që ishin me të.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së enjtes së javës së 34-t të Letrave (1 Jn. 1:8-2:6).

UNGJILLI i së enjtes së javës së 17-të të Llukait (Mk. 13:31-14:2).

26. E premte. Dëshmore Fotinia, samaritane, Anatolia etj. Porfiri i Gazës. Dëshmor Theokliti.

Hahen të gjitha.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së premtes së javës së 34-t të Letrave (1 Jn. 2:7-17).

UNGJILLI i së premtes së javës së 17-të të Llukait (Mk. 14:3-9).

27. † E shtunë. Omologjet Prokop Dekapoliti. Dëshmorët Gjelas Aktori dhe Nisi. Oshënar Asklipi. Stefan Gjerokomi.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i së shtunës së javës së 34-t të Letrave (1 Tim. 6:11-16).

UNGJILLI i së shtunës së javës së 17-të të Llukait (Llk. 20:46-21:4, 8:8).

28. † E DIEL. DJALI PLANGPRISHËS. Apostujt Evuli, Nimfai, nga të 70-t. Vasil Omologjeti (Pohuesi). Oshënare Marana dhe Kira. (*Oshënar Kasiani, 29 shkurt*).

Tingulli Tërthor I. Ungjilli mëngjesor ngjallësor V.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...”, thuhet 7 Vargëzime ngjallësore dhe 2 Vargëzimet e vetëmelodishme të Triodit, të cilat bëhen 3 (e para thuhet 2 herë). “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. Tërth. I: “Në Detin e Kuq...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe PARAVARGU i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja e Pasvargjeve të tingullit, por sipas tingullit të Lavdisë.

PËRLËSHORET ngjallësore: “Fjalën e panisëshme...”. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja: “Gëzohu, derë e Zotit...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, Përlëshorja ngjallësore: “Fjalën e panisëshme...”. “Lavdi...”, po ajo: “Fjalën

e panisëshme...”. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Gëzohu, derë e Zotit...”.

NDENJËSORET ngjallësore sipas radhës.

BEKIMTORET ngjallësore, DËGJIMI, SHKALLESAT dhe PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA (e tingullit dhe e Triodit), SHTËPIA (e tingullit dhe e Triodit) dhe SINAKSARI (i ditës dhe i Triodit).

ZBRITËSORET: “Nis, o shpirt, e këndo...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor V.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmit 50 thuhet: “Lavdi...”, “Hapmi dyert e pendimit...”. “Tani...”, “Drejtomë në rrugët...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Unë i mjeri, duke kujtuar...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në fund Zbritësorja IX: “Cili ka dëgjuar...”.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore V dhe e Triodit.

LAVDËRIMET: 5 Vargëzimet ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e Triodit. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, “E përmbibekuar je, o Hyjlindëse...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e të dielave.

Pas HYRJES, Përlëshorja ngjallësore dhe e shenjtiti të kishës.

SHKURTORJA e Triodit.

Paravargu dhe Aliluari i së dielës.

APOSTULLI i së dielës së javës së 34-t të Letrave
(1 Kor. 6:12-20).

UNJILLI i së dielës së 17-të të Llukait (Llk.
15:11-32).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të
meriton...”.

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdëroni Zotin...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.